




**BULETINI PERIODIK I
PRAKTIKËS GJYQËSORE
PERIODIČNI BILTEN
SUĐSKE PRAKSE**



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

**KORRIK– SHTATOR
JULI - SEPTEMBAR
2024**

III

Buletini periodik i praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese

(Korrik - Shtator 2024)

Buletini periodik i praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese përmban përmbledhjen e aktgjykimeve dhe aktvendimeve me rëndësi dhe interes të veçantë, të cilat janë publikuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) gjatë periudhës së fundit tre (3) muajore.

Në këtë Buletin janë pasqyruar fillimisht përmbledhjet e aktgjykimeve që ndërlidhen me kërkesat institucionale, përderisa përmbledhja e aktgjykimeve në rastet individuale është renditur sipas pretendimeve të bazuara në nenet specifike të Kapitullit II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta).

Buletini periodik i praktikës gjyqësore është një dokument që publikohet në baza periodike dhe është përgatitur vetëm për çështje informative. Përmbledhjet e pasqyruara në këtë Buletin përmbajnë esencën e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës dhe konstatimit të Gjykatës dhe për këtë arsye çdo interpretim dhe analizë e tyre duhet bërë në dritën e Aktgjykimeve të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe ueb-faqen e Gjykatës Kushtetuese:

www.gjk-ks.org

Për të pranuar Buletinin periodik të praktikës gjyqësore në postën tuaj elektronike, ju lutemi të regjistrohemi në ueb-faqen e Gjykatës:

www.gjk-ks.org/publikimet/buletini-periodik

Vërejtje: Kushdo që dëshiron të kopjojë, përkthejë apo shfrytëzojë për qëllime të tjera të gjitha ose një pjesë të informacioneve të përmbajtura në Buletin, duhet të kontaktojë Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese për udhëzime të mëtejshme.

Periodiçni bilten sudske prakse Ustavnog suda

(Juli– Shtetor 2024. godine)

Periodiçni bilten sudske prakse Ustavnog suda sadrži sažetke presuda i rešenja od posebnog značaja i interesa, koje je Ustavni sud Republike Kosovo (u daljem tekstu: Sud) objavio u poslednja tri (3) meseca.

U ovom Biltenu prvo su prikazani sažetci presuda u vezi sa institucionalnim zahtevima, dok je sažetak presuda u individualnim predmetima naveden u redosledu prema navodima zasnovanim na posebnim članovima Poglavlja II Ustava Republike Kosovo (u daljem tekstu: Ustav).

Periodiçni bilten sudske prakse je dokument koji se objavljuje periodično i pripremljen je samo u informativne svrhe. Sažeci prikazani u ovom Biltenu sadrže suštinu navoda podnosilaca zahteva i nalaze Suda i stoga svako njihovo tumačenje i analiza mora biti urađeno u svetlu presuda objavljenih u Službenom listu Republike Kosovo i na sajtu Ustavnog suda:

www.gjk-ks.org

Da biste primali Periodiçni bilten sudske prakse na svoju adresu elektronske pošte, molimo vas registrujte se na internet stranici Suda:

<https://gjk-ks.org/sr/publikacije/periodicni-bilten/>

Napomena: Svako ko želi da kopira, preveđe ili za druge svrhe koristi sve ili deo informacija sadržanih u ovom Biltenu treba da kontaktira Sekretarijat Ustavnog suda za dalja uputstva.

“Perandori Justinian” nr. 44, 10 000 Prishtinë

Tel: +383 (0) 38 60 61 62

Mob: +383(0) 45 200 595; +383(0) 45 200 576

Fax: +383(0) 38 60 61 70

Email: gjkata.kushtetuese@gjk-ks.org

©Gjykata Kushtetuese 2024

Tabela e përmbajtjes/Pregled sadržaja

- I. **Nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]; 7 [Vlerat]; 24 [Barazia para Ligjit]; 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; 46 [Mbrojtja e Pronës]; 65 [Kompetencat e Kuvendit]; 106 [Papajtueshmëria]; 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]; 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]; 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës]; dhe 142 [Agjencitë e Pavarura]**

KO46/23, Parashtrues: *Abelard Tahiri dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.....13

- Aplikimi retroaktiv i ligjit në raport me barrën e provës për subjektin e verifikimit, i cili nuk përfiton nga një garanci e arsyeshme procedurale, bazuar në të cilën do të mund të argumentonte para gjykatës kompetente “*pamundësinë objektive*” për të siguruar dhe/ose paraqitur një provë që shkon në favor të justifikueshmërisë së pasurisë që është objekt verifikimi dhe/ose konfiskimi nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] dhe pargarfët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- Rregullimi i periudhës së verifikimit të pasurisë së paluajtshme gjatë ushtrimit dhe pas përfundimit të funksioneve të zyrtarëve përkatës, në kuptim të “*qartësisë*” dhe “*parashikueshmërisë*” është në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës.
- Përbërja e Komisionit për Mbikëqyrje të Byrosë Shtetërore, e cila përfshin gjyqtarin e Gjykatës Supreme, në cilësi të kryesuesit, dhe Zëvendësavokatin e Popullit dhe Auditorin e Përgjithshëm, si anëtarë, nga këndvështrimi i kompetencave të këtij komisioni të përcaktuar me Ligjin e kontestuar, është në papajtueshmëri me funksionet e tyre kushtetuese, të përcaktuara në nenin 106 [Papajtueshmëria]; nenit 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]; dhe nenet 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës] dhe 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës] të Kushtetutës.

- I. **Çlanovi 4. [Oblik vladanja i podela vlasti]; 7. [Vrednosti]; 24. [Jednakost pred zakonom]; 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]; 32. [Pravo na pravno sredstvo]; 46. [Zaštita imovine]; 65. [Nadležnosti Skupštine]; 106. [Nespojivost funkcija]; 132. [Uloga i nadležnosti Ombudsmana]; 136. [Stalni revizor Kosova]; 137. [Nadležnosti stalnog revizora Kosova] i 142. [Nezavisne agencije]**

KO46/23, podnosilac zahteva: *Abelard Tahiri i 9 (devet) drugih poslanika Skupštine Republike Kosovo*, Ocena ustavnosti Zakona br. 08/L-121 o državnom birou za proveru i oduzimanje neopravdane imovine.....13

- Retroaktivna primena zakona u odnosu na teret dokazivanja za subjekta provere, koji ne koristi razumnu procesnu garanciju, na osnovu koje bi mogao da argumentuje pred nadležnim sudom “*objektivnu nemogućnost*” da pruži i/ili iznese dokaz koji ide u prilog opravdanosti imovine koja je predmet provere i/ili oduzimanja, nije u skladu sa stavom 1. člana 7. [Vrednosti] i stavovima 1. i 2. člana 46. [Zaštita imovine] Ustava u vezi sa članom 1. (Zaštita imovine) Protokola br. 1 Evropske konvencije o ljudskim pravima.

- Regulisanje perioda provere nepokretnosti za vreme obavljanja i po prestanku funkcije relevantnih službenika, u smislu „jasnoće“ i „predvidljivosti“, je u suprotnosti sa stavom 1. člana 7. [Vrednosti] Ustava.
- Sastav Nadzorne komisije Državnog biroa, koju čine sudija Vrhovnog suda, kao predsedavajući, zamenik Ombudsmana i Stalni revizor, kao članovi, sa stanovišta ovlašćenja ove Komisije definisana osporenim zakonom, nije u skladu sa njihovim ustavnim funkcijama definisanim u članu 106. [Nespojivost funkcija]; članu 132. [Uloga i nadležnosti Ombudsmana]; članu 136. [Stalni revizor Kosova] i članu 137. [Nadležnosti Stalnog revizora Kosova] Ustava.

II. Nenet 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] dhe 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër]

KO114/23, KO192/23, KO227/23 dhe KO229/23, Parashtrues: *Gjykata Supreme*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 4 (*Ne Bis In Idem*), paragrafit 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) dhe paragrafit 2 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës Nr. 08/L-032 (Kodi i Procedurës Penale).....18

- Rishikimi i procedurës penale, për dallim nga mjete juridik i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, bie qartësisht në fushëveprimin e nenit 34 [E Drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës dhe nenit 4 (E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë) të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut në rast se (i) të dy procedurat janë me natyrë “penale”; dhe nëse ky është rasti, (ii) të dy procedurat të jenë të ndërlidhura me të njëjtën vepër për të cilën një person është “*liruar apo dënuar*” me një “*vendim përfundimtar*”.
- Mundësia e parashtrimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga Prokurori i Shtetit në Gjykatën Supreme kundër vendimit të formës së prerë për ndërprerjen e paraburgimit nuk është në kundërshtim me nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës.
- Mundësia e Gjykatës Supreme që përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të ushtruar nga Prokurori i Shtetit, të vendosë edhe në dëm të të pandehurit në rast se vendimi i formës së prerë është “*qartazi i papërshtatshëm ose i bazuar në gabim të rëndë*” nuk është në kundërshtim me nenin 34 [E Drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] të Kushtetutës.

II. Çlanovi 29. [Pravo na slobodu i sigurnost] i 34. [Pravo lica da mu se ne sudi dva puta za isto krivično delo]

KO114/23, KO192/23, KO227/23 i KO229/23, podnosilac zahteva: *Vrhovni sud*, Ocena ustavnosti stava 2. člana 4. (*Ne Bis In Idem*), stava 4. člana 432. (Razlozi za podnošenje zahteva za zaštitu zakonitosti) i stava 2. člana 438. (Presuda o zahtevu za zaštitu zakonitosti) Zakonika o krivičnom postupku Republike Kosovo br. 08/L-032 (Zakonik o krivičnom postupku).....18

- Preispitivanje krivičnog postupka, za razliku od pravnog sredstva zahteva za zaštitu zakonitosti, jasno spada u delokrug člana 34. [Pravo lica da mu se ne sudi dva puta za isto

krivično delo] Ustava i člana 4. (Pravo da se ne bude suđen ili kažnjen dvaput u istoj stvari) Protokola br. 7 Evropske konvencije o ljudskim pravima u slučaju da (i) su oba postupka „krivične“ prirode; i ako je to slučaj, (ii) oba postupka se odnose na isto krivično delo za koje je lice „oslobođeno ili osuđeno pravosnažnom odlukom“.

- Mogućnost podnošenja zahteva za zaštitu zakonitosti od strane državnog tužioca Vrhovnom sudu protiv pravosnažne odluke o ukidanju pritvora nije u suprotnosti sa članom 29. [Pravo na slobodu i sigurnost] Ustava.

- Mogućnost da Vrhovni sud, putem zahteva za zaštitu zakonitosti koji podnosi državni tužilac, odluči i na štetu okrivljenog u slučaju da je pravosnažna odluka „očigledno neprikladna ili zasnovana na ozbiljnoj greški“ nije u suprotnosti sa članom 34. [Pravo lica da mu se ne sudi dva puta za isto krivično delo] Ustava.

III. Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit], dhe neni 142 [Agjencitë e Pavarura]

KO157/23, Parashtrues: *Vlora Dumoshi dhe 11 deputetë tjerë*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 08-V-583 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 13 korrikut 2023, për shkarkimin e anëtares së Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.....22

Shkarkimi i një anëtari/eje të Organit Shqyrtues të Prokurimit nga ana e Kuvendit për shkak të vendimmarrjes në raste konkrete, me arsyetimin se ka shkelur rregullat e “*Etikës profesionale*” duke mos argumentuar në mënyrë bindëse shkeljen e këtyre rregullave, cenon pavarësinë funksionale të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe vet qëllimin e ekzistencës së tij, sipas përcaktimeve të ligjeve të aplikueshme, dhe si i tillë nuk është në përputhshmëri me paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe paragrafin 1 të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës.

III. Çlan 65. [Nadležnosti Skupštine] i çlan 142. [Nezavisne agencije]

KO157/23, podnosilac zahteva: *Vlora Dumoshi i 11 drugih poslanika*, Ocena ustavnosti odluke br. 08-V-583 Skupštine Republike Kosovo o razrešenju članice Odbora Tela za razmatranje nabavki od 13. jula 2023. godine.....22

Razrešenje člana/ce Tela za razmatranje nabavki od strane Skupštine zbog odlučivanja u konkretnim slučajevima, na osnovu toga što je povredila pravila „*Profesionalne etike*“ time što nije ubedljivo argumentovala povredu ovih pravila, predstavlja povredu funkcionalne nezavisnosti Tela za razmatranje nabavki i samu svrhu njegovog postojanja, prema odredbama važećih zakona, i kao takva nije u skladu sa stavom 9, člana 65. [Nadležnosti Skupštine] i stavom 1, člana 142. [Nezavisne agencije] Ustava.

IV. Nenet 24 [Barazia para Ligjit], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale]

KO158/23, Parashtrues: *Besnik Tahiri dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr.08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale, Procedurat e Caktimit të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të Ardhurat Personale Vjetore24

- Dallimi i lartësisë së pensioneve dhe/ose kompensimeve në mes të veteranëve të UÇK-së, personave të verbër dhe personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë nuk përbën dallim në trajtim.
- Nuk ka shkelje të të drejtave pronësore, të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut, të ndërlidhura me pritjet legjitime për një lartësi të caktuar të pensioneve dhe/ose beneficioneve që ndërlidhen me lartësinë ose një shkallë të lartësisë së pagës minimale në Republikën e Kosovës.
- Përcaktimi i lartësisë së pagës minimale nga Qeveria, sipas propozimit të Këshillit Ekonomik-Social, por duke e shtuar mundësinë që vet Qeveria të përcaktojë pagën minimale në rast se mungon një propozim i tillë nuk është në kundërshtim me nenin 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës.

IV. **Çlanovi 24. [Jednakost pred zakonom], 46. [Zaštita imovine] i 51. [Pravo na zdravstvenu i socijalnu zaštitu]**

KO158/23, podnosilac zahteva: *Besnik Tahiri i devet (9) drugih poslanika Skupštine Republike Kosovo*, Oocena ustavnosti Zakona br. 08/L-142 o izmenama i dopunama zakona koji utvrđuju visinu beneficije u visini minimalne plate, procedure određivanja minimalne plate i porezne stope na godišnji lični dohodak24

- Razlika u visini penzija i/ili naknada između veterana OVK, slepih osoba i paraplegičara i tetraplegičara ne predstavlja razliku u tretmanu.
- Nema povrede imovinskih prava, zagaranovanih članom 46. [Zaštita imovine] Ustava i članom 1. (Zaštita imovine) Protokola br. 1 Evropske konvencije o ljudskim pravima u vezi sa legitimnim očekivanjima za određeni nivo penzija i/ili beneficija koje se odnose na nivo ili stepen minimalne plate u Republici Kosovo.
- Određivanje visine minimalne plate od strane Vlade, prema predlogu Ekonomsko-socijalnog saveta, ali dodavanje mogućnosti da Vlada sama utvrđuje minimalnu platu u nedostatku takvog predloga, nije u suprotnosti sa članom 51. [Pravo na zdravstvenu i socijalnu zaštitu] Ustava.

V. **Nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 101 [Shërbimi Civil]**

KO232/23 dhe KO233/23, Parashtrues: *Abelard Tahiri dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë dhe Besian Mustafa dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-180 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.....29

- Përjashtimi i kompetencës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për të vendosur lidhur me ankesat e nëpunësve civilë dhe/ose kandidatëve për pranim në shërbimin civil në pozita të larta drejtuese kundër vendimeve të Qeverisë, por duke u garantuar të drejtën e ankesës në gjykatën kompetente në konflikt administrativ nuk është në përputhshmëri me pargrafën 1

të nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] në ndërlidhje me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës;

- Eliminimi i dispozitës aktuale ligjore që garanton imunitetin në vendimmarrje të anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nuk është në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës

- Zhveshja e statusit të vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nga “ekzekutueshmëria” e tyre nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

V. Çlanovi 24. [Jednakost pred zakonom], 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje], 32. [Pravo na pravno sredstvo] i 101. [Civilna služba]

KO232/23 i KO233/23, podnosilac zahteva: *Abelard Tahiri i 10 (deset) drugih poslanika i Besian Mustafa i 10 (deset) drugih poslanika Skupštine Republike Kosovo*, Ocena ustavnosti Zakona br. 08/L-180 o izmenama i dopunama Zakona br. 06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru za civilnu službu Kosova.....29

- Isključuje nadležnost Nezavisnog nadzornog odbora da odlučuje po žalbama državnih službenika i/ili kandidata za prijem u državnu službu na visoke rukovodeće funkcije protiv odluka Vlade, ali garantujući pravo na žalbu nadležnom sudu u upravnom sporu, nije u skladu sa stavom 1, člana 24. [Jednakost pred zakonom] i članom 32. [Pravo na pravno sredstvo] u vezi sa stavom 2, člana 101. [Civilna služba] Ustava.

- Ukidanje postojeće zakonske odredbe kojom se garantuje imunitet u odlučivanju članova Nezavisnog nadzornog odbora nije u skladu sa stavom 2, člana 101. [Civilna služba] Ustava.

- Oduzimanje statusa odluka Nezavisnog nadzornog odbora od njihove „izvršnosti“ nije u skladu sa stavom 1, člana 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava.

VI. Nenet 7 [Vlerat], 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore]

KO248/23, Parashtrues: *Ferat Shala dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-209 për Investime të Qëndrueshme.....33

Promovimi, përkrahja dhe mbrojtja e investimeve të qëndrueshme dhe eksportit në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe vendosjen e objektivave shtetërore dhe sektorëve prioritarë për zhvillim, të rregulluar me Ligjin e kontestuar për Investimet e Qëndrueshme nuk është në kundërshtim me ekonominë e tregut më konkurrencë të lirë si vlerë e rendit kushtetues dhe parimet në lidhje me rregullimin e marrëdhënieve ekonomike, të përcaktuara me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 2 të nenit 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore] të Kushtetutës.

VI. Çlanovi 7. [Vrednosti], 119. [Osnovna načela] i 122. [Korišćenje prirodnih izvora i bogatstava]

KO248/23, podnosilac zahteva: *Ferat Shala i devet (9) drugih poslanika Skupštine Republike Kosovo*, Ocena ustavnosti Zakona br. 08/L-209 o održivim ulaganjima.....33

Promocija, podrška i zaštita održivih ulaganja i izvoza u Republici Kosovo, uključujući uspostavljanje državnih ciljeva i prioriteta sektora za razvoj, regulisanih osporenim Zakonom o održivim ulaganjima nije u suprotnosti sa tržišnom privrednom i slobodnom konkurencijom kao vrednosti ustavnog poretka i načela koja se odnose na uređenje privrednih odnosa, definisanih stavom 1, člana 7. [Vrednosti], članom 119. [Osnovna načela] i stavom 2, člana 122. [Korišćenje prirodnih izvora i bogatstava] Ustava.

VII. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

(i) E drejta për qasje në gjykatë

KI04/23, Parashtrues: *Avdyl Bajgora*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev. Nr. 43/2022], të 10 tetorit 2022, të Gjykatës Supreme.....37

Interpretimi tejet formalist i rregullave procedurale nga ana e Gjykatës Supreme në lidhje me vlerën e objektit të kontestit, përkatësisht kufizimit *ratione valoris*, si kriter për lejueshmërinë e mjetit juridik - revizionit, rezultoi në kufizimin e të drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në gjykatë, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

KI172/23, Parashtruese: *Rejhane Ceka, Fiknete Ceka, Lejlane Ceka dhe Sara Ceka*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev. nr. 216/2023], të 19 qershorit 2023, të Gjykatës Supreme.....40

Aplikimi i pragut *ratione valoris* nga Gjykata Supreme, duke anashkaluar aplikimin e dispozitave të aplikueshme ligjore që ndërlidhen me bashkë-ndërgjyqësinë dhe përcaktimin e vlerës së objektit të kontestit, në tërësinë e tyre dhe jo në mënyrë të izoluar ka rezultuar në “*formalizëm të tepruar*”, i cili nuk është proporcional me qëllimin legjitim të kufizimit *ratione valoris* për qasje në gjykatë, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

KI199/22, Parashtrues: *P.T.P. “Arta XH”*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [E. Rev. nr. 75/20], të 1 gushtit 2022, të Gjykatës Supreme.....42

Dështimi i gjykatave të shkallës më të ulët për të përcaktuar vlerën e kontestit në procedurë gjyqësore ka rezultuar në pamundësinë e parashtruesit të kërkesës për të pasur qasje në Gjykatën Supreme, dhe si rezultat i një aplikimi tejet formalist të kufizimit *ratione valoris*, atij i është cenuar e drejta për qasje në gjykatë, e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

VII. Član 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]

(i) Pravo na pristup sudu

KI04/23, podnosilac zahteva: Avdyl Bajgora, Ocena ustavnosti rešenja [Rev. br. 43/2022] Vrhovnog suda Kosova, od 10. oktobra 2022.godine.....37

Veoma formalističko tumačenje proceduralnih pravila od strane Vrhovnog suda u pogledu vrednosti predmeta spora, odnosno ograničenja *ratione valoris*, kao kriterijuma za dozvoljenost pravnog sredstva – revizije, rezultiralo je ograničenjem prava podnosioca zahteva na pristup sudu, zagarantovanog članom 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava i članom 6. ((Pravo na pravično suđenje) Evropske konvencije o ljudskim pravima.

KI172/23, podnosilac zahteva: *Rejhane Ceka, Fiknete Ceka, Lejlane Ceka i Sara Ceka*, Ocena ustavnosti rešenja [Rev. br. 216/2023], Vrhovnog suda, od 19. juna 2023. godine.....40

Primena praga *ratione valoris* od strane Vrhovnog suda, zanemarujući primenu važećih zakonskih odredbi koje se odnose na suparnični postupak i utvrđivanje vrednosti predmeta spora, u celini, a ne izolovano, rezultirala je u „*prekomernom formalizmu*“, koji nije proporcionalan legitimnoj svrsi ograničenja pristupa sudu *ratione valoris*, zagarantovanog članom 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava i članom 6. (Pravo na pravično suđenje) Evropske konvencije o ljudskim pravima.

KI199/22, podnosilac zahteva: *P.T.P. “Arta XH”*, Ocena ustavnosti rešenja, Vrhovnog suda [E. Rev. br. 75/20], od 1. avgusta 2022. godine.....42

Propust nižestepenih sudova da utvrde vrednost spora u sudskom postupku doveo je do nemogućnosti podnosioca zahteva da ima pristup Vrhovnom sudu, a kao rezultat veoma formalističke primene ograničenja *ratione valoris*, njemu je povređeno pravo na pristup sudu, zagarantovano članom 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava i članom 6. (Pravo na pravično suđenje) Evropske konvencije o ljudskim pravima.

(ii) Cenimi i parimit të sigurisë juridike

KI190/22, Parashtrues: *Ramiz Isaku*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-21-0642], të 31 gushtit 2022, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.....44

Aplikimi në mënyrë jo-konsistente nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës i ligjeve të aplikueshme përkritazi me kontestet që ndërlidhen me kompensimin e pagave të ish-punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore, përkatësisht Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 dhe Ligjit për Punën e Bashkuar të vitit 1976, në lidhje me afatin e parashkrimit, përfshirë vlerësimin se një jo-konsistencë e tillë reflekton “*dallime të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore të kësaj gjykate, të ndërlidhura me mospërdorimin e mekanizmave të përcaktuar me ligj e të dizajnuar për të harmonizuar praktikën përkatëse gjyqësore cenon parimin e sigurisë juridike dhe përbën shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

(ii) Povreda načela pravne sigurnosti

KI190/22, podnosilac zahteva: *Ramiz Isaku*, Ocena ustavnosti presude [AC-I-21-0642], Žalbenog veća Posebne komore Vrhovnog suda, od 31. avgusta 2022. godine.....44

Nedosledna primena od strane Posebne komore Vrhovnog suda Kosova važećih zakona u vezi sa sporovima u vezi sa naknadom plata bivših zaposlenih u društvenim preduzećima, odnosno Zakona o obligacionim odnosima iz 1978. godine i Zakona o udruženom radu iz 1976. godine, u vezi sa rokom zastarevanja, uključujući i ocenu da ovakva nedoslednost odražava „*duboke i dugoročne razlike*“ u sudskoj praksi ovog suda, a koje se odnose na nekorišćenje mehanizama utvrđenih zakonom i osmišljenih da usklade relevantnu sudsku praksu, krši načelo pravne sigurnosti i predstavlja povredu prava na pravično i nepristrasno suđenje zagarantovano članom 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava i članom 6. (Pravo na pravično suđenje) Evropske konvencije o ljudskim pravima.

(iii) E drejta për një vendim të arsyetuar dhe e drejta për mbajtjen e seancës dëgjimore

KI23/24, Parashtrues: *Agim Zogaj*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-21-0836-A0001], të 26 tetorit 2023, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.....46

Konkluzioni i përgjithshëm dhe arsyetimi i pamjaftueshëm në lidhje me parashkrimin e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës rezultoi në shkelje të së drejtës së tij për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Mbajtja e seancës dëgjimore në të paktën njërën nga instancat gjyqësore është detyrim kushtetues, ndërsa përderisa përjashtimet nga ky parim janë të mundshme, rrethanat e rastit konkret nuk përkojnë me mundësinë e këtij përjashtimi dhe, rrjedhimisht, nuk kanë ekzistuar rrethana të cilat do të mund të justifikonin mungesën e seancës dëgjimore.

(iii) Pravo na obrazloženu odluku i pravo na održavanje rasprave

KI23/24, podnosilac zahteva: *Agim Zogaj*, Ocena ustavnosti presude [AC-I-21-0836-A0001], Žalbenog veća Posebne komore Vrhovnog suda Kosova od 26. oktobra 2023. godine46

Opšti zaključak i nedovoljno obrazloženje u pogledu zastarelosti tužbenog zahteva podnosioca zahteva su doveli do povrede njegovog prava na obrazloženu sudsku odluku zagarantovanog članom 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava i članom 6. (Pravo na pravično suđenje) Evropske konvencije o ljudskim pravima.

Održavanje ročišta u najmanje jednoj od sudskih instanci je ustavna obaveza, dok su izuzeci od ovog načela mogući, okolnosti konkretnog slučaja se ne poklapaju sa mogućnošću ovog izuzetka, te, shodno tome, nije bilo okolnosti koje bi mogle opravdati odsustvo ročišta.

(iv) Interpretimi qartazi arbitrar dhe i gabuar i ligjit

KI103/24, Parashtrues: *Sylejman Zeneli*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev. Nr. 485/2022], të 5 janarit 2023, të Gjykatës Supreme.....48

Interpretimi i dispozitës përkatëse të Marrëveshjes Kolektive nga ana e Gjykatës Supreme, i interpretuar në mënyrë të shkëputur dhe duke shpërfillur faktin se parashtruesi i kërkesës kishte vendim të formës së prerë për kthim në vendin e punës rezultoi në konkluzione arbitrarë për parashtruesin e kërkesës, në kundërshtim me të drejtën e tij për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

(iv) Oçigledno proizvoljno i pogrešno tumačenje zakona

KI103/24, podnosilac zahteva: *Sylejman Zeneli*, Ocena ustavnosti presude [Rev. br. 485/2022], Vrhovnog suda, od 5. januara 2023. godine.....48

Tumačenje relevantne odredbe Kolektivnog ugovora od strane Vrhovnog suda, protumačeno na nepovezan način i zanemarujući činjenicu da je podnosilac zahteva imao pravosnažnu odluku da se vrati na radno mesto, rezultiralo je proizvoljnim zaključcima za podnosioca zahteva u suprotnosti sa pravom na pravično suđenje zagantovano članom 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje] Ustava i članom 6. (Pravo na pravično suđenje) Evropske konvencije o ljudskim pravima.

(v) Parimi i kontradiktoritetit

KI177/22, Parashtrues: *Pashk Bibaj*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-II-21-0058], të 23 majit 2022, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.....50

Si rezultat i mosnjofimitit të parashtruesit të kërkesës për transferimin e lëndës nga Gjykata e Apelit në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, atij i ishte mohuar e drejta për të kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore në këtë instancë, e cila rezultoi në cenimin e të drejtës së tij për t'u dëgjuar, e garantuar me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

(v) Načelo kontradiktornosti

KI177/22, podnosilac zahteva: *Pashk Bibaj*, Ocena ustavnosti presude [AC-II -21-0058] Žalbenog veća Posebne komore Vrhovnog suda Kosova za pitanja koja se odnose na Kosovsku agenciju za privatizaciju od 23. maja 2022. godine.....50

Kao rezultat neobaveštavanja podnosioca zahteva o ustupanju predmeta sa Apelacionog suda na Žalbeno veće Posebne komore Vrhovnog suda, uskraćeno mu je pravo da zahteva ročište u ovoj instanci, što je dovelo do povrede njegovog prava da bude saslušan, zagantovanog stavom 1, člana 31. Ustava u vezi sa stavom 1, člana 6. Evropske konvencije o ljudskim pravima.

VIII.Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

KI272/23, Parashtrues: *Ali Tahiri*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AKPA. II. nr. 163/23] të Prokurorisë së Apelit, të 1 nëntorit 2023.....53

Mosmarrja parasysh e ankesës së parashtruesit të kërkesës në procedurë të kallëzimit penal, të dorëzuar në Prokurorinë e Apelit përmes postës brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale rezultoi në shkeljen e të drejtës së tij për mjete juridike të garantuar me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushteutës.

VIII. Član 32. [Pravo na pravno sredstvo]

KI272/23, podnosilac zahteva: *Ali Tahiri*, Ocena ustavnosti rešenja [AKPA. II. br. 163/23] Apelacionog tužilaštva od 1. novembra 2023. godine.....53

Nerazmatranje žalbe podnosioca zahteva u postupku krivične prijave, podnete Apelacionom tužilaštvu preko pošte u roku utvrđenom odredbama Zakonika o krivičnom postupku, imalo je za posledicu povredu njegovog prava na pravno sredstvo zagaranovanog članom 32. [Pravo pravno sredstvo] Ustava.

I. Neneti 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]; 7 [Vlerat]; 24 [Barazia para Ligjit]; 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; 46 [Mbrotjtja e Pronës]; 65 [Kompetencat e Kuvendit]; 106 [Papajtueshmëria]; 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]; 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]; 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës]; dhe 142 [Agjencitë e Pavarura]

KO46/23, Parashtrues: *Abelard Tahiri dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit Nr. 08/L-121 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme

Aplikimi retroaktiv i ligjit në raport me barrën e provës për subjektin e verifikimit, i pamundëson këtij të fundit që të përfitojë nga një garanci e arsyeshme procedurale, bazuar në të cilën do të mund të argumentonte para gjykatës kompetente “pamundësinë objektive” për të siguruar dhe/ose paraqitur një provë që shkon në favor të justifikueshmërisë së pasurisë që është objekt verifikimi dhe/ose konfiskimi.

Rregullimi i periudhës së verifikimit të pasurisë së paluajtshme gjatë ushtrimit dhe pas përfundimit të funksioneve të zyrtarëve përkatës, në kuptim të “qartësisë” dhe “parashikueshmërisë” është në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike.

Përbërja e Komisionit për Mbikëqyrje të Byrosë Shtetërore me gjyqtarin e Gjykatës Supreme, në cilësi të kryesuesit, dhe zëvendësavokatit të Popullit dhe Auditorit të Përgjithshëm, si anëtarë, nga këndvështrimi i kompetencave të këtij komisioni, është në papajtueshmëri me funksionet e tyre të përcaktuara me Kushtetutë.

Ligji i kontestuar

Ligji i kontestuar themelon Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme (Byroja Shtetërore), duke e përfshirë në rendin juridik të Republikës së Kosovës edhe konceptin e konfiskimit civil të

I. Çlanovi 4. [Oblik vladanja i podela vlasti]; 7. [Vrednosti]; 24. [Jednakost pred zakonom]; 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]; 32. [Pravo na pravno sredstvo]; 46. [Zaštita imovine]; 65. [Nadležnosti Skupštine]; 106. [Nespojivost funkcija]; 132. [Uloga i nadležnosti Ombudsmana]; 136. [Stalni revizor Kosova]; 137. [Nadležnosti stalnog revizora Kosova] i 142. [Nezavisne agencije]

KO46/23, podnosilac zahteva: *Abelard Tahiri i 9 (devet) drugih poslanika Skupštine Republike Kosovo*, Ocena ustavnosti Zakona br. 08/L-121 o državnom birou za proveru i oduzimanje neopravdane imovine

Retroaktivna primena zakona u odnosu na teret dokazivanja za subjekta provere, koji ne koristi razumnu procesnu garanciju, na osnovu koje bi mogao da argumentuje pred nadležnim sudom „objektivnu nemogućnost“ da pruži i/ili iznese dokaz koji ide u prilog opravdanosti imovine koja je predmet provere i/ili oduzimanja.

Regulisanje perioda provere nepokretnosti za vreme obavljanja i po prestanku funkcije relevantnih službenika, u smislu „jasnoće“ i „predvidljivosti“, je u suprotnosti načelom pravne sigurnosti.

Sastav Nadzorne komisije Državnog biroa, koju čine sudija Vrhovnog suda, kao predsedavajući, zamenik Ombudsmana i Stalni revizor, kao članovi, sa stanovišta ovlašćenja ove Komisije, nije u skladu sa njihovim ustavnim funkcijama definisanim u Ustavu.

Osporeni zakon

Osporeni zakon osniva Državni biro za proveru i oduzimanje neopravdane imovine (Državni biro), uključujući u pravni poredak Republike Kosovo i koncept građanskopravnog oduzimanja neopravdane

pasurisë së pajustificueshme, përkatësisht dhe në esencë, konfiskimin e pasurisë pa nevojën e vërtetimit në procedurë penale që pasuria përkatëse është fituar përmes kryerjes së veprës penale. Për këtë qëllim, Ligji i kontestuar, përcakton procedurën për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme nga personat zyrtarë dhe palët e treta, (i) për pasurinë e fituar në mënyrë të pajustificuar duke filluar nga 17 shkurti 2008 dhe në parim, brenda dhjetë (10) viteve nga momenti kur zyrtarët përkatës pushojnë së ushtruari funksionet e tyre, me saktësimin që verifikimit të pasurisë, përjashtimisht mund të i nënshtrohet edhe pasuria e fituar pas përfundimit të ushtrimit të funksionit zyrtar dhe (ii) Byroja ka kompetencën për të vlerësuar masën pasurore të secilit zyrtar në raport me të hyrat e ligjshme dhe në rast të vlerësimit që ka shpërputhje në mes të hyrave dhe pasurisë që tejkalon vlerën prej njëzetepesëmijë (25,000) euro, mund të propozojë sigurimin e pasurisë përmes masës së përkohshme dhe më pas, konfiskimin e të njëjtës pas vendimit përkatës gjyqësor. Marrë parasysh që procedura e verifikimit dhe konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme është e pavarur nga procedura penale, standardi i të provuarit është ai i “vlerësimit të gjasave” dhe sipas të cilit, pasuria cilësohet e pa/justifikueshme, nëse gjykata bazuar në prova *“beson që një gjë ka më shumë mundësi të jetë apo të ketë ndodhur se sa jo”*.

Ligji i kontestuar, themelon Byronë Shtetërore, e cila udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm me mandat shtatë (7) vjeçar, ndërsa mbikëqyrësit nga një Komision Mbikëqyrës i përbërë nga (i) një gjyqtar i Gjykatës Supreme i caktuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme, në cilësinë e kryesuesit të Komisionit; (ii) Auditori i Përgjithshëm; (iii) Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit; (iv) zëvendës Avokati i Popullit; dhe (v) Drejtori i Njësisë së Inteligjencës Financiare. Ky Komision, i cili vendos me shumicën e anëtarëve në kuadër të kuorumit vendimmarrës prej katër (4) anëtarësh, ka kompetencën e plotë mbikëqyrëse të të gjitha funksioneve të Byrosë Shtetërore, përfshirë miratimin e të gjitha akteve nënligjore.

imovine, odnosno u suštini, oduzimanje imovine bez potrebe dokazivanja u krivičnom postupku da je predmetna imovina stečena izvršenjem krivičnog dela. U tu svrhu, osporenim zakonom je definisan postupak provere i oduzimanja imovine stečene na neopravdan način od strane službenih lica i trećih lica, (i) za movinu stečenu na neopravdan način počev od 17. februara 2008. godine, a u principu, u roku od deset (10) godina od trenutka kada dotični službenici prestanu da obavljaju svoje funkcije, uz preciziranje da predmet provere imovine, izuzetno, može biti i imovina stečena po prestanku vršenja službene funkcije, i (ii) biro ima nadležnost da izvrši procenu imovinskog stanja svakog funkcionera u odnosu na zakonite prihode i u slučaju procene da postoji nesklad između prihoda i imovinskog stanja koje prelazi vrednost od dvadeset pet hiljada (25.000) evra, može predložiti obezbeđenje imovine putem privremene mere, a potom i oduzimanje iste nakon odgovarajuće sudske odluke. S obzirom na to da je postupak provere i oduzimanja neopravdane imovine nezavisan od krivičnog postupka, standard dokazivanja je standard „procene verovatnoće“ i po kome se imovina kvalifikuje kao ne/opravana, ako sud na osnovu dokaza *„veruje da postoji veća verovatnoća da se nešto desi ili da se već desilo nego da do istog nije došlo“*.

Osporeni zakon osniva Državni biro, kojim rukovodi generalni direktor, na mandat od sedam (7) godina njega nadzire Nadzorna komisija sastavljena od (i) jednog sudije Vrhovnog suda koga imenuje predsednik Vrhovnog suda u svojstvu predsedavajućeg Komisije; (ii) generalnog revizora; (iii) direktora Agencije za sprečavanje korupcije; (iv) zamenika Ombudsmana; i (v) direktora Finansijske obaveštajne jedinice. Ova Komisija, koja odlučuje većinom članova u okviru kvoruma za odlučivanje od četiri (4) članova, ima punu nadzornu nadležnost nad svim funkcijama Državnog biroa, uključujući i usvajanje svih podzakonskih akata.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë (i) që ligji i aplikueshëm bën dallimin në mes personave zyrtarë dhe qytetarëve tjerë të Republikës së Kosovës dhe vet personave zyrtarë që kanë ushtruar funksione para dhe pas 17 shkurtit 2008; (ii) aplikimi retroaktiv i ligjit, përtej shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore, cenon parimin e sigurisë juridike, duke krijuar pasiguri për individët që duhet të justifikojnë pasurinë e fituar para viteve të caktuara, për shkak se imponon një barrë disproporcionale mbi individët për të justifikuar pasurinë e tyre për periudha të gjata kohore; dhe (iii) se kompetencat e Kuvendit janë transferuar në mënyrë të paligjshme te Komisioni Mbikëqyrës i Byrosë Shtetërore, i cili ka papajtueshmëri kushtetuese në përbërje, sidomos për sa i përket rolit të zëvendës Avokatit të Popullit, dhe gjithashtu vënë theks në mungesën e pavarësisë së Byrosë Shtetërore, përfshirë në kontekst të mënyrës së zgjedhjes së Drejtorit të Përgjithshëm të saj.

Vlerësimi i Gjykatës

Konstatimet më esenciale si rezultat i vlerësimit të Gjykatës ndërlidhen me tri kategori gjithëpërfshirëse çështjesh, përkatësisht (i) fushëveprimin e Ligjit të kontestuar lidhur me barazinë para ligjit, sigurinë juridike dhe proporcionalitetin e aplikimit retroaktiv të ligjit në raport me barrën e provës së individit; (ii) garancitë procedurale në kontekst të verifikimit dhe/ose konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme; dhe (iii) çështjet institucionale, përkatësisht mekanizmat e mbikëqyrjes së Byrosë Shtetërore, përfshirë pa/pajtueshmërinë e funksioneve kushtetuese të anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës.

Së pari, në lidhje me fushëveprimin retroaktiv të ligjit në raport me barrën e provës së individit, Gjykata vlerësoi se kontestuese është nëse aplikimi retroaktiv i ligjit për një periudhë më të gjatë se pesëmbëdhjetë (15) vjeçare, përkatësisht nga 17 shkurti 2008, është proporcional me të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të verifikimit në kontekst të barrës së provës dhe i cili, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por edhe të

Navodi podnosioca zahteva

Podnosioci zahteva navode da (i) osporeni zakon pravi razliku između službenih lica i drugih građana Republike Kosovo i samih službenih lica koja su obavljala funkcije pre i posle 17. februara 2008. godine; (ii) retroaktivna primena zakona, mimo povrede osnovnih prava i sloboda, krši načelo pravne sigurnosti, stvarajući neizvesnost za pojedince koji moraju da opravdaju imovinu stečenu pre određenih godina, jer nameće nesrazmeran teret pojedincima da opravdaju svoju imovinu na duži vremenski period; i (iii) da su ovlašćenja Skupštine nezakonito preneti na Nadzornu komisiju Državnog biroa, koja ima ustavnu neusklađenost u svom sastavu, posebno u pogledu uloge zamenika Ombudsmana, a takođe naglašava i nedostatak nezavisnosti Državnog biroa, uključujući i u kontekstu načina izbora njegovog generalnog direktora.

Ocena Suda

Najvažniji nalazi kao rezultat ocene Suda se odnose na tri sveobuhvatne kategorije pitanja, odnosno (i) delokrug primene osporenog zakona povodom jednakosti pred zakonom, pravne sigurnosti i proporcionalnosti retroaktivne primene zakona u odnosu na teret dokazivanja pojedinca; (ii) proceduralne garancije u kontekstu provere i/ili oduzimanja neopravdane imovine; i (iv) institucionalna pitanja, odnosno mehanizmi nadzora Državnog biroa, uključujući ne/spojivost ustavnih funkcija članova Nadzorne komisije.

Prvo, u pogledu retroaktivnog delokruga zakona u odnosu na teret dokazivanja pojedinca, Sud je ocenio da je sporno da li je retroaktivna primena zakona za period duži od petnaest (15) godina, odnosno od 17. februara 2008. godine, srazmerna osnovnim pravima i slobodama subjekata provere u kontekstu tereta dokazivanja i koja je, prema sudskoj praksi Evropskog suda za ljudska prava, ali i mišljenjima Venecijanske

Opinioneve të Komisionit të Venecias, është i domosdoshëm në kontekst të arsyeshmërisë dhe/ose “*mundësisë objektive*” të individit për të siguruar dhe prezantuar dëshmitë e nevojshme në mbështetje të argumentimit të justifikueshmërisë së pasurisë që i nënshtrohet verifikimit dhe/ose konfiskimit.

Gjykata vlerësoi se, përkundër faktit që Ligji i kontestuar ndjek qëllimin legjitim të interesit publik, i njëjti në vlerësimin e Gjykatës, nuk reflekton një baraspeshë të arsyeshme në mes të shtetit dhe individit, mes tjerash, sepse (a) periudha e aplikueshmërisë retroaktive të ligjit, në parim, tejkalon afatet e përcaktuara në ligjet relevante të aplikueshme në kontekst të mbajtjes së regjistrave dhe/ose të dhënave, (b) në rrethana në të cilat e tërë administrata shtetërore është e detyruar të bashkëpunojë me Byronë, ndërsa barra e provës rreth justifikueshmërisë së pasurisë kontestuese bie mbi individin, dhe (c) i cili, nuk përfiton nga një garanci e arsyeshme procedurale, bazuar në të cilën, do të mund të argumentonte para gjykatës kompetente “*pamundësinë objektive*” për të siguruar dhe/ose paraqitur një provë që shkon në favor të justifikueshmërisë së pasurisë që është objekt verifikimi dhe/ose konfiskimi.

Në lidhje me parimin e sigurisë juridike në kontekst të “*qartësisë*” dhe “*parashikueshmërisë*” së dispozitave të Ligjit të kontestuar, të cilat rregullojnë periudhën e verifikimit të pasurisë së paluajtshme gjatë ushtrimit dhe pas përfundimit të funksioneve të zyrtarëve përkatës, Gjykata vlerësoi se dispozitat respektive të Ligjit të kontestuar, mes tjerash, nuk qartësojnë saktësisht dhe në mënyrë të parashikueshme periudhat kohore përgjatë të cilave pasuria e fituar mund t’i nënshtrohet verifikimit, përfshirë periudhat kohore përgjatë të cilave mund të fillojë procedura e verifikimit të pasurisë, si për pasurinë e fituar gjatë ushtrimit të funksionit ashtu edhe për pasurinë e fituar pas përfundimit të funksionit përkatës.

Së dyti, përkritazi me garancitë procedurale në kontekst të verifikimit dhe/ose konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme, Gjykata vuri theks në tri çështje parësore, përkatësisht në (i) të drejtën për t’u mos inkriminuar; (ii) të drejtën e

komisije, neophodna u kontekstu razumnosti i/ili “*objektivne mogućnosti*” pojedince da obezbedi i predstavi potrebne dokaze u prilog argumentovanja opravdanosti imovine koja je predmet provere i/ili konfiskacije.

Sud je ocenio da pored činjenice da osporeni zakon teži legitimnom cilju javnog interesa, isti, po oceni Suda, ne odražava razumnu ravnotežu između države i pojedinca, između ostalog, jer (i) period retroaktivne primene zakona, u principu, prelazi rokove propisane relevantnim primenjivim zakonima u kontekstu vođenja registara i/ili podataka, (ii) u okolnostima u kojima je cela državna uprava dužna da sarađuje sa Biroom, dok teret dokazivanja o opravdanosti sporne imovine pada na pojedinca, i (iii) koji nema koristi od razumne procesne garancije, na osnovu koje bi pred nadležnim sudom mogao da argumentuje “*objektivnu nemogućnost*” da obezbedi i/ ili predoči dokaze koji idu u prilog opravdanosti imovine koja je predmet provere i/ili oduzimanja.

Što se tiče načela pravne sigurnosti u smislu “*jasnoće*” i “*predvidivosti*” odredaba osporenog zakona, koje regulišu period provere nepokretne imovine za vreme vršenja i nakon prestanka funkcija dotičnih službenika, Sud je ocenio da relevantne odredbe osporenog zakona, između ostalog, ne razjašnjavaju precizno i predvidivo vremenske periode u kojima stečena imovina može biti predmet provere, uključujući i periode u kojima može započeti postupak provere imovine, kako za imovinu stečenu tokom vršenja funkcije i za imovinu stečenu po završetku dotične funkcije.

Drugo, što se tiče proceduralne garancije u kontekstu provere i/ili oduzimanja neopravdane imovine, Sud je istakao tri principijelna pitanja, odnosno (i) pravo da ne bude inkriminisan; (ii) pravo stranke da bude

palës për t'u njoftuar për të gjitha procedurat e zhvilluara në kontekst të verifikimit të pasurisë, përfshirë ndërlidhur me vendosjen e masave të sigurisë në pasurinë kontestuese; dhe (iii) parimin e sigurisë juridike, duke vlerësuar që Ligji i kontestuar, në parim, ofron garanci të mjaftueshme procedurale për palët në procedurë. Megjithatë ky konstatim sipas Gjykatës nuk e nënkupton edhe ligjshmërinë dhe/ose kushtetutshmërinë e vendimeve të Byrosë Shtetërore dhe/ose gjykatave të rregullta.

